

Tabela e përmbajtjes

Hyrje	3
Qëllimi i udhëzuesit	3
Ligji i aplikueshëm	3
Komisioni i Ankesave.....	4
Fushëveprimi i Komisionit të Ankesave.....	4
Çështjet që mund të parashtrohen pranë Komisionit të Ankesave	4
Palët e autorizuara.....	5
Pranueshmëria e ankesës.....	5
Objekti i ankesës	6
Afatet kohore	6
Komunikimi me anëtarët e Komisionit të Ankesave	6
Seanca dëgjimore	7
Vendimmarrja e Komisionit të Ankesave.....	7
Procedura e vendimmarrjes.....	8

Komisioni i Ankesave i Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) në përputhje me nenin 22 të Ligjit për AKA-në Nr. 08/L-110 si dhe Rregulloren Nr. 01/2024 për Punën e Komisionit të Ankesave të AKA-së, me datë 04/10/2024 miratoi këtë Udhëzues për Institucionet e Arsimit të Lartë për Procesin e Ankimimit në Komisionin e Ankesave.

Hyrje

Bazuar në Standardet dhe Udhëzuesit Evropian për Sigurimin e Cilësisë (ESG) agjencitë e sigurimit të cilësisë duhet të kenë procese të ankimimit të cilat i sigurojnë institucioneve të arsimit të lartë vendimmarrje të drejtë.

Sipas ESG (Standardi 2.7), përmes procesit të ankimimit, institucionit i lejohet të kërkojë rishqyrtimin e rezultatit përfundimtar të procesit të vlerësimit të jashtëm në rast se institucioni mund të demonstrojë se ai rezultat nuk është arritur në bazë të dëshmive, që kriteret gjatë procesit nuk janë aplikuar në mënyrë të drejtë dhe se procesi nuk është zbatuar në mënyrë konsistente.

Qëllimi i udhëzuesit

Ky udhëzues ka për qëllim që të përcaktojë aspektet procedurale të procesit të ankimimit në Komisionin e Ankesave të Agjencisë së Kosovës për Akreditim.

Qëllimi i dokumentit është t'i ofrojë institucioneve të arsimit të lartë udhëzime të qarta dhe transparente të procesit të ankimimit për të siguruar se ankesat të cilat shqyrtohen nga Komisioni i Ankesave në mënyrë të drejtë dhe të paanshme, duke kontribuar kështu në rritjen e integritetit dhe të besueshmërinë së proceseve të sigurimit të jashtëm të cilësisë.

Udhëzuesi synon të rrisë vetëdijesimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë për rezultatet e vlerësimit të jashtëm për të cilat mund të parashtrohet një ankesë.

Ligji i Aplikueshëm

Procesi i ankimimit në Agjencinë e Kosovës për Akreditim parashihet në Ligjin për Agjencinë e Kosovës për Akreditim Nr. 08/L-110.

Puna e organit shqyrtues të ankesave pranë AKA-së, (përcaktohet?) me Rregulloren Nr. 01/2024 për Punën e Komisionit të Ankesave të AKA-së.

Për të gjitha çështjet që nuk parashihen me Ligjin për AKA-në apo me Rregulloren Nr.01/2024 për Punën e Komisionit të Ankesave, aplikohen përshtatshëmrisht dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Komisioni i Ankesave

Organi kompetent për trajtimin e ankesave të institucioneve të arsimit të lartë është Komisioni i Ankesave.

Komisioni i Ankesave përbëhet nga pesë (5) anëtarë të përhershëm nga të cilët tre (3) janë juristë me të paktën pesë (5) vjet përvojë profesionale dhe dy (2) profesorë universitarë, të cilët kanë njohuri të thella të sistemit të arsimit të lartë dhe të proceseve të sigurimit të cilësisë.

Detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e Komisionit të Ankesave përcaktohen në Ligjin për AKA-në si dhe në Rregullores së Punës së Komisionit të Ankesave të Agjencisë së Kosovës për Akreditim Nr. 01/2024.

Fushëveprimi i Komisionit të Ankesave

Në bazë të Ligjit të Agjencisë, Komisioni i Ankesave shqyrton vetëm aspektet procedurale të rezultateve të vlerësimit të jashtëm, përkatësisht të akreditimit, monitorimit, dhe validimit, për të cilat institucioni pranon vendim nga KSHC.

Çështjet që mund të parashtrihen pranë Komisionit të Ankesave

Institucioni i arsimit të lartë i pakënaqur me vendimin e Këshillit Shtetëror të Cilësisë (KSHC) ka të drejtë të dorëzojë ankesë për të gjitha rezultatet e proceseve të vlerësimit të jashtëm të cilësisë.

Institucioni i arsimit të lartë mund të parashtrijë ankesë pranë Komisionit të Ankesave vetëm pasi të ketë pranuar një vendim përfundimtar nga KSHC në lidhje me procedurën e vlerësimit të jashtëm dhe në përputhje me këshillën juridike të përcaktuar në atë vendim.

Ankesa e dorëzuar nga institucioni i arsimit të lartë duhet të fokusohet vetëm në aspektin procedural të procesit të vlerësimit të jashtëm i cili ka përfunduar me një vendim të KSHC-së.

Palët e Autorizuara

Sipas Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037, vetëm bartësit e arsimit të lartë, publik dhe privat, legjitimohen si palë për të parashtruar ankesë pranë Komisionit të Ankesave.

Personat e tjerë fizik përfshirë studentët, stafi akademik, stafi administrativ apo pjesëtar të tjerë të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë janë (prekur, ndikuar?) nga vendimet e KSHC-së nuk konsiderohen palë të legjitimuara për të parashtruar ankesë pranë Komisionit të Ankesave. Institucioni i Arsimit të Lartë, përmes një njoftimi paraprak me shkrim, përcakton personin zyrtar apo autoritetin mënxhues të institucionit, si palë të autorizuar të institucionit të arsimit të lartë për parashtrimin e ankesës.

Njoftimi duhet të përmbajë emrin dhe mbiemrin e përfaqësuesit, pozitën, adresën fizike, postën elektronike dhe numrin kontaktues. Institucioni i Arsimit të Lartë bart përgjegjësinë për saktësinë e të dhënave në mënyrë që të sigurojë komunikimin e rregullt me Komisionin e Ankesave.

Pranueshmëria e ankesës

Për tu pranuar ankesa për shqyrtim nga KA, kërkesa duhet:

- të dorëzohet në AKA brenda 30 ditëve pas pranimit të vendimit me shkrim nga KSHC;
- të dorëzohet në kopje fizike dhe elektronike pranë zyrave të AKA-së;
- t'i drejtohet Komisionit të Ankesave, si organ kompetent për shqyrtimin e ankesës;
- të formulohet saktë si ankesë kundër një vendimi të caktuar të KSHC-së;
- të përmbajë saktë emrin e institucionit dhe datën e dorëzimit;
- të përmbajë objektin e ankesës, duke iu referuar qartë gabimeve specifike procedurale apo moszbatimit të drejtë të procedurës së vlerësimit të jashtëm;
- të nënshkruhet nga personi zyrtar i autorizuar i institucionit të arsimit të lartë.

Në rast se Institucioni i Arsimit të Lartë parashtron ankesa për vendime të ndryshme, secila prej tyre duhet të plotësohet dhe paraqitet ndaras, dhe të përmbajë të gjitha elementet e një ankese.

Ankesa dorëzohet në administratën e AKA-së me të cilin rast përfaqësuesi i IAL pranon kopje të protokoluara të ankesës si konfirmim se ankesa është pranuar dhe do të shqyrtohet.

Komisioni i Ankesave fillimisht konfirmon se kriteret për pranueshmërinë e ankesës janë përmbushur për të proceduar tutje shqyrtimin e përmbajtjes.

Në rast se ankesa nuk përmban elementet e mësipërme, Komisioni i Ankesave mund të refuzojë shqyrtimin e ankesës.

Objekti i ankesës

Objekt të ankesës pranë KA-së, mund të përbejnë rastet kur institucioni i arsimit të lartë (IAL) dëshmon me fakte se AKA gjatë procesit të vlerësimit, akreditimit, riakreditimit, validimit, monitorimit ka arritur në konkluzione të gabuara të cilat afektojnë të drejtat e IAL, dhe në të gjitha rastet tjera kur KSHC me vendim vendos për IAL-në përkatëse, me të cilin kjo e fundit nuk është e kënaqur.

Ankesa e Institucionit të Arsimit të Lartë mund të shoqërohet me dokumente, dëshmi dhe prova materiale, që e mbështesin pretendimin e ngritur në ankesë. Komisioni i Ankesave nuk merr në shqyrtim dokumentet, dëshmitë apo informacionet të reja, të cilat nuk kanë qenë të prezantuara me parë pranë KSHC-së apo të cilat gjatë kohës së procedurës së vlerësimit të jashtëm nuk kanë ekzistuar.

Afatet kohore

Institucioni i arsimit të lartë dorëzon ankesën në AKA jo më larg se tridhjetë (30) ditë nga data e pranimit të vendimit të KSHC-së.

Administrata e AKA-së në një afat optimal përcjell tek anëtarët e Komisionit të Ankesave të gjitha shkresat e lëndës të dorëzuara nga institucioni i arsimit të lartë.

Në rast të paqartësive apo nevojës për informacione shtesë, Komisioni i Ankesave përmes administratës së AKA-së mund të kërkojë nga Institucioni i Arsimit të Lartë dokumentacion apo informacion shtesë.

Komisioni i Ankesave shqyrton ankesën brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të ankesës.

Në rast se Komisioni i Ankesave konsideron se ankesa është komplekse dhe zgjidhja e saj kërkon kohë shtesë, sipas ligjit në fuqi, Komisioni mund të dyfishojë afatin për shqyrtimin e ankesës jo më larg se gjashtëdhjetë (60) ditë nga data e parashtrimit të ankesës.

Për shtyrjen e afatit për tridhjetë (30) ditë tjera, Institucioni i Arsimit të Lartë njoftohet me kohë përmes postës elektronike nga administrata e AKA-së.

Komunikimi me anëtarët e Komisionit të Ankesave

Komunikimi ndërmjet anëtarëve të Komisionit për Ankesa dhe Institucionit të Arsimit të Lartë ndërmjetësohet nga Drejtori i AKA-së ose njëri nga zyrtarët administrativ të AKA-së.

Komunikimi kryesisht ndodh përmes postës elektronike në adresat e zyrtarëve të autorizuar të Institucionit të Arsimit të Lartë.

Seanca dëgjimore

Institucioni i Arsimit të Lartë i cili ka dorëzuar ankesë ka të drejtë për seancë dëgjimore gjatë procesit të ankimit.

Seanca dëgjimore i mundëson institucionit të paraqes argumentet e ngritura në ankesë, të sqarojë detaje rreth ankesës dhe t'i përgjigjet pyetjeve eventuale të anëtarëve të Komisionit.

Ftesa për seancë dëgjimore vendoset nga Komisionit i Ankesave ndërsa institucioni konsultohet paraprakisht nga administrata e AKA-së përmes postës elektronike për datën dhe kohën e përshtatshme për mbajtjen e seancës dëgjimore.

Në seancë dëgjimore mund të marr pjesë përfaqësuesi zyrtar i Institucionit të Arsimit të Lartë, përfshirë ndonjë person tjetër zyrtar i institucionit, të cilët kanë informacione substanciale për objektin e ankesës dhe mund të ofrojë sqarime të nevojshme për anëtarët e Komisionit të Ankesave.

Hapja e seancës dëgjimore bëhet nga Kryetari, ose në mungesë të tij nga Kryesuesi i Komisionit të Ankesave. Përfaqësuesi i Institucionit të Arsimit të Lartë ka në dispozicion pesëmbëdhjetë (15) minuta kohë për të mbrojtur pretendimet e ngritura në ankesës. Pohimet e parashtrësive të ankesës duhet të jenë konkrete, koncize dhe të ndërlidhen vetëm me çështjen që është objekt shqyrtimi pranë Komisionit të Ankesave. Anëtarët e komisionit, sipas nevojës mund të parashtrojnë pyetje shtesë me qëllim të sqarimit të çështjeve që ndërlidhen me ankesën.

Gjatë seancës dëgjimore, çdo deklaratë, pyetje ose çështje e ngritur nga anëtarët e Komisionit të Ankesave ka për synim vetëm të lehtësojë kuptimin e plotë të ankesës dhe nuk paragjykon vendimin përfundimtar të Komisionit të Ankesave.

Vendimmarrja e Komisionit të Ankesave

Vendimet e Komisionit të Ankesave merren me shumicë të votave të anëtarëve që janë prezent në mbledhje.

Kuorumi i Komisionit të Ankesave, përmbushet kur janë prezent tre (3) anëtarë në mbledhje. Nëse ndonjëri nga anëtarët nuk mund të jetë prezent fizikisht në mbledhje, ai/ajo mund të marrë pjesë online nëpërmjet platformave adekuate.

Nëse njëri prej anëtarëve të Komisionit është në një situatë që potencialisht mund të kufizojë kapacitetin e tij për të bërë gjykime objektive dhe profesionale, veçanërisht duke marrë parasysh dispozitat për konfliktin e interesit, anëtari përkatës nuk shpreh pikëpamjet e tij për rastin në fjalë dhe abstenon nga votimi.

Votimi është i hapur me ngritje dore, “për” ose “kundër”. Anëtari/ja që ka marrë pjesë online në mbledhje për këshillim dhe votim, duhet të deponojë votën e tij/saj në mënyrë elektronike, ose në formë të shkruar, në mënyrë që vota e tij/saj të përfshihet në procesverbal.

Komisioni i Ankesave mban procesverbal të takimeve, përfshirë diskutimet kryesore, propozimet dhe rezultatet e votimit për ankesën përkatëse.

Procesverbali nënshkruhet nga Kryetari i Komisionit të Ankesave, dhe nga përfaqësuesi i AKA-së dhe votohet në mbledhjen e radhës, jo më vonë se katërmëdhjetë dite nga mbajtja e mbledhjes paraprake.

Institucioni i Arsimit të Lartë mund të kërkojë një kopje të procesverbalit, nëse e njëjta i shërben për ndjekjen e hapave të mëtejme administrative apo shfrytëzimin e mjeteve ligjore pranë gjykatës kompetente administrative.

Procedura e vendimmarrjes

Sipas ligjit në fuqi, Komisioni i Ankesave mund të refuzojë ankesën apo të aprovojë atë.

Në rast të refuzimit të ankesës, vendimi i Komisionit të Ankesave është përfundimtar. Nëse Institucioni i Arsimit të Lartë është i pakënaqur me vendimin e Komisionit të Ankesave, ai, në afat prej tridhjetë (30) ditëve, mund t'i drejtohet gjykatës kompetente për iniciimin e konfliktit administrativ.

Në rast të aprovimit të ankesës, lënda kthehet tek KSHC për rivendosje. KSHC në procedurën e rishqyrtimit dhe rivendosjes për çështjen, merr parasysh rekomandimet e Komisionit të Ankesave, në mënyrë që të riparojë shkeljet e ligjit. Pas kësaj faze, vendimi i KSHC-së është përfundimtar në procedurë administrative, kundër të cilit pala e pakënaqur, në afat prej tridhjetë (30) ditësh mund të fillojë konflikt administrativ në gjykatën administrative.

Struktura e vendimit te Komisionit të Ankesave përcaktohet nga komisioni dhe vendimi përmban të gjitha elementet e përcaktuara sipas ligjit në fuqi.

Vendimi i Komisionit të Ankesave, nënshkruhet nga Kryetari, ose në mungesë të tij, për arsye të konflikt të interesit, nga Kryesuesi i Komisionit të Ankesave.

Në rast të lëshimit të gabimeve gjuhësore, teknike apo të tjera në vendimet e Komisionit të Ankesave, me kërkesë të Institucionit të Arsimit të Lartë dhe sipas detyrës zyrtare, Komisioni i Ankesave mund të korrigojë në çdo kohë gabimin e lëshuar teknik.

Kryesues i Komisionit të Ankesave



Prof. Asoc. Dr. Kemajl Zeqiri

